

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/10

Datë: 31.05.2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës Nr.03/L-040, neni 17 paragrafi (f), Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Rregullores Nr.02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.05.2018, nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. Për krijimin e Ndërmarrjes Publike Komunale për menaxhimin e shërbimeve komunale si në vijim:
 1. Ujit të pijes,
 2. Ujit të ujitjes,
 3. Ujërave të zeza,
 4. Mirëmbajtjes së rrugëve komunale,
 5. Mirëmbajtjes varrezave komunale,
 6. Mirëmbajtjes parqeve dhe shesheve komunale.
- II. Selia objekti, emri i ndërmarrjes, mënyra e organizimit dhe mënyra e funksionimit do të përcaktohen me akt të veçantë (Statut) mbi themelimin e ndërmarrjes.
- III. Komuna e Junikut si themeluese e kësaj ndërmarrje do të sigurojë asetet e nevojshme për funksionimin e kësaj ndërmarrje.
- IV. Ndërmarrja do të funksionoi mbi bazat e vetëfinancimit, kurse Komuna do të ruajë të drejtën e pronësisë mbi asetet.
- V. Kuvendi i Komunës çdo vit buxhetor benë aprovimin e tarifave të shërbimeve që i ofron, planin buxhetor vjetor dhe raportin vjetor të ndërmarrjes.
- VI. Komuna formon komisionin e veçantë për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm sipas ligjit për regjistrimin e ndërmarrjes tek organi kompetent pranë Ministrisë për Zhvillim Ekonomik.


VII. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e aprovimit dhe dërgimi ne Zyrën ligjore të MAPL-së, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria për Zhvillim Ekonomik.

Me këtë vendim të njoftohet:

- Kryetari i Komunës
- Drejtori i DSHPI-së
- MAPL,
- Arkiva e Komunës-Junik.

Kryesues i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/11

Datë: 31.05.2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 12.2, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 21, paragrafi 21.1 pika j) Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.05.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

për procedurës për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Varrezave Komunale

- I. Me këtë vendim fillohet procedura për hartimin e Rregullores për Menaxhimin e Varrezave Komunale/ në tekstin e mëtejme projekt rregullorja.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për menaxhimin e varrezave.
- III. Bartëse e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi është Drejtoria për Administratë.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartoj në afat prej 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Autorizohet Kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta emëroj grupin punues për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi.
- VI. (projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit (projekt) Rregullorja i procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anë të të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.


- X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës respektivisht Drejtoria për Administratë.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Kryetari i komunës së Junikut
- Shërbimi i Kuvendit,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/12

Datë: 31.05.2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12 paragrafi 12.2 pika d), Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 22 paragrafi 22.1 pika 4, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.05.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

për miratimin e anëtareve të KKSBB-së

- I. Me këtë vendim miratohet lista e anëtareve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut/ në tekstin e mëtejme KKSBB .
- II. KKSBB-ja përbehet nga: (neni 4 udhëzim administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi)
 1. **Agron Kuçi** – kryetar i Komunës së Junikut,
 2. **Rasim Syla** – komandant i Stacionit Policor në Junik,
 3. **Imer Krasniqi** – përfaqësues i Bashkësisë Islame,
 4. **Avni Muslijaj** – përfaqësues i komunitetit halvetije,
 5. _____ - kryesues i Komitetit për Komunitete,
 6. **Xhevahire Krasniqi** – zyrtare për barazi gjinore,
 7. **Fatos Shala** - drejtori i drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini e Sport
 8. **Zenel Kuçi** – kryetar i Këshillit të prindërve të arsimit të Komunës së Junikut,
 9. _____ - përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës,
 10. **Demë Salla** – kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi,
 11. **Shkëlzen Shehu** – përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
 12. **Turim Ganiqaj** – përfaqësuese i zyrës komunale për komunitete dhe kthim,
 13. **Haki Jasiqi** – përfaqësuese nga OJQ,
 14. **Mehmet Saliqaj** – përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.
- III. Në përjashtim me nenin 4 udhëzim administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi nga përbërja e lartpërmendur mungojnë:
 1. një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike – nuk janë të themeluara Këshillat për Siguri Publike,
 2. përfaqësues nga mediat lokale – nuk ka media lokale.


IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL - MPB,
- Të emeruarit,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/13
Datë: 31.05. 2018

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 53, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 36 dhe 38, dhe pas kërkesës për rishqyrtimin e ligjshmërisë nga Departamenti Ligjor i MAPL-së, të datës 26.04.2018, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.05.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komitetit për Komunitete

- I. Me këtë vendim Kuvendi themelon Komitetin për Komunitete si komitet i përhershëm në Komunën e Junikut dhe përcakton strukturën e tij.
- II. Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë neni 10, paragrafi 2, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete zgjidhet me shumicën e votave të anëtareve të Komitetit.
- III. Komiteti për Komunitete do të ketë përbërjen si në vijim:
 1. Dardane Shala - anëtare, subjekti politik AAK - PDK,
 2. Kreshnik Maloku - anëtarë, subjekti politik AAK - PDK,
 3. _____ - anëtarë/e, subjekti politik LDK,
 4. Zenel Maloku - anëtarë, kandidat i pavarur,
 5. Drita Salihu - Hoxha - anëtare, subjekti politik LVV,
- IV. Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL,
- Anëtarët e Komitetit për Komunitete,
- Drejtori për Ekonomi Buxhet dhe Financa,
- Arkiva.

Kryesuesi i Këshillit të Përbashkët të Komuniteteve
z. Muharrem Krasniqi

